

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 5 të Ligjit për gjykatat, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 06.02.2023, miratoi:

## **P R O G R A M I N E P U N Ë S**

### **të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023**

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kompetencën e saj kushtetuese dhe ligjore si gjykatë më e lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut e realizon në pajtim me Kushtetutën, ligjet, Marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën, Rregulloren gjyqësore dhe akte të tjera nënligjore.

Me Programin e punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për periudhën nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023 definohe punët dhe detyrat punuese nga fushëveprimi i punës së Gjykatës në procesin e veprimit të drejtë me qëllim që të sigurohet:

- **Zbatimi i paanshëm i drejtësisë pavarësisht nga pozita dhe cilësia e palëve;**
- **Mbrojtja, respektimi dhe përparimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;**
- **Sigurimi i barazisë, barabarësisë, mos diskriminimit për çfarë do baze;**
- **Vendosja cilësore dhe në kohë e lëndëve në kompetencën e Gjykatës**
- **Ofrimi i sigurisë juridike përmes unifikimit të praktikës gjyqësore në bazë të sundimit të së drejtës;**
- **Realizimi i principeve për gjykim në afat të arsyeshëm dhe sigurimi i kushteve për qasjen më të shpejtë në drejtësi;**
- **Transparenca dhe publiku në punën e Gjykatës, për sigurimin e informimit në kohë të palëve dhe publikut për vendimet e Gjykatës;**

- **Zbatimi konsekuent i Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën; ligjeve proceduese dhe materiale dhe akteve të tyre nënligjore, Ligjit për gjykatat, Ligjit për shërbimin gjyqësor, Rregulloren gjyqësore dhe Rregulloren e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut;**
- **Harmonizimi i praktikës gjyqësore dhe sigurimi i barazisë në zbatimin e ligjeve nga gjykatat;**
- **Respektimi dhe veprimi i vendimeve përfundimtare dhe përmbaruese të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Marrëveshje të tjera të ratifikuara në pajtim me Ligjin;**

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjyqtarët dhe të punësuarit në Gjykatën janë të obliguar të sigurojnë realizimin e Programit të miratuar për periudhën e shënuar.

## **1) Detyrat e programit**

### **1.1. Administrata gjyqësore**

Kryetari i Gjykatës do të udhëheq dhe menaxhojë me Gjykatën, do t'i kryejë punët nga fushëveprimi i administratës gjyqësore dhe do të organizojë punën e Gjykatës.

Kryetari i Gjykatës do të prezantojë Gjykatën dhe të ndërmerr masa për kryerjen e punëve në rregull dhe në kohë, do të sigurojë zbatimin e Rregullores gjyqësore, do të miratojë Orarin e punës së Gjykatës, do të veprojë për parashtresat dhe ankesat e palëve dhe organeve tjera, për kërkesat për vendosjen e lëndëve me prioritet, për kërkesat për përjashtime të parashtruara nga gjyqtarët dhe palët dhe do të ndërmerr veprime tjera për të cilat është kompetent në pajtim me Ligjin, Rregulloren gjyqësore dhe Rregulloren e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për kryerjen e punëve me sukses, në kohë dhe në rregull të administratës gjyqësore, kryetari i Gjykatës mund t'ia besojë detyrat e punës zëvendësit të tij ose ndonjë gjyqtari tjetër, gjyqtarit kryetar të Sektorit, administratorit gjyqësor ose ndonjë nëpunësi tjetër, dhe sipas nevojës do të organizojë edhe ekipin e tij për punën në kabinet.

Në rast të pengesës ose mungesës, kryetarin e Gjykatës e zëvendëson zëvendësi i kryetarit të Gjykatës.

Administratori gjyqësor do të menaxhojë me shërbimin gjyqësor, do të jetë përgjegjës për realizimin dhe kryerjen e punëve teknike administrative dhe profesionale në Gjykatë, do të bashkëpunojë dhe do t'i ndihmojë Kryetarit të Gjykatës në kryerjen e

punëve nga administrata gjyqësore, do të ndjek realizimin e punëve të punësuarve në shërbimin gjyqësor, zbatimin e Rregullores gjyqësore nga ana e të punësuarve në Gjykatën, përveç policisë gjyqësore.

Kryetari i Gjykatës rregullisht fton Seancë të gjyqtarëve për shqyrtimin dhe realizimin e Programit të punës së Gjykatës dhe shqyrtimin, analizën dhe ndërmarrjen e masave për raportet e punës së Gjykatës, përshtatjen e punës së Sektorëve, dhënien e mendimeve nga kompetenca e Seancës së gjyqtarëve dhe për çështje tjera nga puna e Gjykatës.

## **1.2. Organizimi i punës**

Kompetencën e saj kushtetuese dhe ligjore për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe ofrimin e barazisë në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut e kryen përmes miratimit të qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike parimore, mendimeve juridike dhe konkluzioneve të nxjerra në:

- Seancë të përgjithshme,
- Seancë të gjyqtarëve dhe
- Seancë të sektorëve.

Në pajtim me nenin 66 paragrafi (1) dhe (2) të Rregullores gjyqësore, në realizimin e kompetencës reale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas llojit të lëndëve dhe vëllimit të punëve, Gjykata do ta realizojë në kuadër të:

- Sektorit të veprave penale,
- Sektorit të veprave civile,
- Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm dhe
- Këshillat e specializuar.

## **1.3. Puna me lëndët**

Qëllimi themelor gjatë veprimit me lëndët është që të sigurohet veprimi i lëndëve në mënyrë profesionale, të paanshme, në kohë dhe veprimin ligjor të lëndëve me respektimin e afateve ligjore dhe afateve për gjykim në afat të arsyeshëm, në pajtim me dispozitat e Rregullores gjyqësore dhe Ligjit për udhëheqjen me qarkullimin e lëndëve në gjykatat, në çdo fazë të procedurës. Evidentimi, shpërndarja, veprimi, vendimmarrja, publikimi, përpilimi i vendimeve, rregullimi në mënyrë anonime i vendimeve të ueb faqes së Gjykatës, do të bëhet tërësisht dhe zbatimi ekskluziv i sistemit të automatizuar kompjuterik për udhëheqjen me lëndët gjyqësore (AKMIS)

Evidentimi i lëndëve do të bëhet sipas kohës së pranimit, ndërsa shpërndarja e lëndëve për gjyqtarët do të bëhet me shpërndarjen automatike në AKMIS. Shpërndarja automatike e lëndëve do të bëhet vetëm në situata të parapara me Rregulloren gjyqësore

dhe në pajtim me Orarin vjetor të punës së Gjykatës, por edhe në ato raste shpërndarja e lëndëve do të bëhet ekskluzivisht me vendim të arsyetuar nga ana e Kryetarit të Gjykatës përmes modulit përkatës në AKMIS, me qëllim që të sigurohet mbrojtja e parimit të shpërndarjes automatike dhe përfshirja e faktorit të njeriut gjatë ndarjes së lëndëve në punë për gjyqtarët.

Gjyqtarët obligohen të japin prioritet në zgjedhjen e lëndëve të cilat me Ligj është shënuar se janë urgjente dhe për të cilat është dhënë prioritet nga ana e Kryetarit të Gjykatës, sidomos për lëndët që janë më interes të lartë publik dhe për të cilat është konstatuar praktikë dhe procedurë për veprimin me përditësim të tyre.

#### **1.4. Sektori i veprave penale**

Në Sektorin e veprave penale veprojnë 5 gjyqtarë.

Në këtë Sektor gjyqtarët veprojnë në:

- këshillat prej 5 gjyqtarëve dhe këshillat prej 3 gjyqtarëve.
- gjyqtari individ dhe këshilli prej 3 gjyqtarëve sipas Ligjit për ndjekjen e komunikimeve.

Kryetari i Sektorit, Kryetari i këshillave, gjyqtarët anëtarë të këshillit dhe zëvendësit e tyre sistemohen me Orarin vjetor të punës.

Gjatë vitit mund të bëhet ndryshimi i Orarit vjetor të punës me vendim të arsyetuar të Kryetarit të Gjykatës për shkaqe arsyetuese dhe për shkak të vëllimit të rritur të punës.

Për gjendjen e Sektorit, kryetari i Sektorit do ta njoftojë rregullisht kryetarin e Gjykatës, sidomos për lëndët për të cilat procedura zgjat më gjatë dhe e kapërcen afatin e arsyeshëm për veprim si dhe për lëndët që janë me interes të lartë publik.

Gjatë vendimmarrjes së lëndëve penale ku është konstatuar parashkrimi i ndjekjes penale duhet që të vërehen shkaqet e të njëjtës, për përgatitjen e raporteve me atë informacion.

Gjatë vendimmarrjes së të gjitha lëndëve penale të vërehen punët lidhur me çështjet juridike për miratimin e mendimeve juridike, konkluzioneve, përgatitjen e sentencave dhe të njëjtat të publikohen në ueb faqen e Gjykatës.

Kryetari i Sektorit, mendimet juridike dhe konkluzionet e Sektorit i dërgon në Sektorin e praktikës gjyqësore, si dhe propozimin me materialin e përgatitur në Seancën e përgjithshme për miratimin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike parimore.

## **1.5. Sektori i veprave civile**

Në Sektorin e veprave civile do të veprojnë Kryetari i Gjykatës si kryetar i Sektorit të veprave civile dhe 7 gjyqtarë dhe deri në zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj në Gjykatën Supreme.

Në këtë Sektor, gjyqtarët veprojnë në këshillat prej 5 gjyqtarëve dhe këshillat prej 3 gjyqtarëve për të gjitha llojet e lëndëve të evidentuara në regjistrat: Rev1, Rev2, Rev3 dhe R.

Kryetari i Sektorit, Kryetari i këshillave, gjyqtarët anëtarë të këshillit dhe zëvendësit e tyre sistemohen me Orarin vjetor të punës.

Gjatë vitit mund të bëhet ndryshimi i Orarit vjetor të punës me vendim arsyetues të Kryetarit të Gjykatës me shkaqe të arsyeshme dhe për shkak të vëllimit të rritur të punës.

Gjatë vendimmarrjes së të gjitha lëndëve civile të vërehen punët lidhur me çështjet juridike për miratimin e mendimeve juridike, konkluzioneve, përgatitjen e sentencave dhe të njëjtat të publikohen në ueb faqen e Gjykatës.

Kryetari i Sektorit, mendimet juridike dhe konkluzionet e Sektorit i dërgon në Sektorin e praktikës gjyqësore, si dhe propozimin me materialin e përgatitur në Seancën e përgjithshme për miratimin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike parimore.

## **1.6. Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm**

Në Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm veprojnë 11 gjyqtarë.

Në këtë Sektor në shkallën e parë – për kërkesat për gjykim në afat të arsyeshëm gjyqtarët do të veprojnë në këshillat me nga 3 gjyqtarë për të gjitha llojet e lëndëve në shkallën e parë.

Për vendimmarrjen e ankesave kundër aktvendimeve të këshillit prej 3 gjyqtarëve për kërkesat për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm do të veprojnë këshilli prej 5 gjyqtarëve.

Kryetari i Sektorit, Kryetari i këshillave, gjyqtarët anëtarë të këshillit dhe zëvendësit e tyre sistemohen me Orarin vjetor të punës.

Gjatë vitit mund të bëhet ndryshimi i Orarit vjetor të punës me vendim arsyetues të Kryetarit të Gjykatës për shkaqe të arsyetuara dhe për shkak të vëllimit të rritur të punës.

Për gjendjen e Sektorit, kryetari i Sektorit e njofton rregullisht kryetarin e Gjykatës, sidomos për lëndët për të cilat procedura zgjat më shumë dhe e kapërcen afatin e arsyeshëm për veprim.

Gjatë vendimmarrjes së lëndëve të vërehen punët lidhur me çështjet juridike për miratimin e mendimeve juridike, konkluzioneve, përgatitjen e sentencave dhe të njëjtat publikohen në ueb faqen e Gjykatës.

Kryetari i Sektorit, mendimet juridike dhe konkluzionet e Sektorit i dërgon në Sektorin e praktikës gjyqësore, si dhe propozimin me materialin e përgatitur në Seancën e përgjithshme për miratimin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike parimore.

## **1.7. Sektori i praktikës gjyqësore**

Në Sektorin e praktikës gjyqësore me Orarin vjetor për punën do të sistemohen Kryetarët e Sektorëve dhe këshilltarët gjyqësorë që i realizojnë detyrat e sekretarëve të Sektorëve.

Sektori i praktikës gjyqësore harmonizon punën e Sektorëve dhe të Seancës së përgjithshme në realizimin e detyrave që kanë të bëjnë me evidencën dhe studimin e praktikës gjyqësore sipas nenit 72 të Rregullores gjyqësore.

Duke qenë se rëndësia për harmonizimin e praktikës gjyqësore si një nga funksionet më të rëndësishme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është i domosdoshëm përforcimi i këtij Sektori, si me resurset njerëzore ashtu edhe me ato informatike, që do të mundësojnë seleksionimin më të lehtë, kategorizimin dhe sistematizimin e vendimeve të Gjykatës, ndërsa baza do të jetë më e qasur për kërkimin e nga ana e përdoruesve.

## **1.8. Këshillat e specializuar**

Në këshillat e specializuar për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të Gjykatës Administrative nga neni 62 të Ligjit për konteste administrative, me propozim për mbrojtje për veprim të kundërligjshëm do të veprojnë gjyqtarët në këshillë prej tre gjyqtarëve.

Në pajtim me nenin 42 paragrafi (5) të Ligjit për këshillin gjyqësor, do të veprojnë këshilli prej 5 gjyqtarëve që do të vendos për ankesën e kandidatit që nuk është zgjedhur për gjyqtar, përkatësisht Kryetar të gjykatës.

Kryetari i këshillit, gjyqtarët anëtarë të këshillit dhe zëvendësit e tyre sistemohen me Orarin vjetor të punës.

Gjatë vitit mund të bëhet ndryshimi i Orarit vjetor të punës me vendim të arsyeshëm të Kryetarit të Gjykatës për shkaqe të arsyeshme dhe për shkak të vëllimit të rritur të punës.

## **1.9. Resurset njerëzore**

Me Vendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut është konstatuar se funksionin e gjyqtarit do ta realizojnë 28 gjyqtarë. Në fillim të vitit 2023 në Gjykatë funksionin e gjyqtarit e realizojnë 11 gjyqtarë dhe Kryetari i Gjykatës. Në fillim të vitit 2023 në muajin janar, një gjyqtar i plotësoi kushtet e pensionit sipas moshës dhe një gjyqtar në muajin shkurt, do t'i plotësojë kushtet për pension sipas moshës.

Duke marrë parasysh numrin e gjyqtarëve dhe numrin e rritur të vendeve të paplotësuara të gjyqtarëve nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër llojin dhe vëllimin e lëndëve, si dhe kompetencën kushtetuese dhe ligjore të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut si gjykatë më lartë e shtetit, gjyqtarët do të bëjnë përpjekje që të mos paraqitet realizimi i rënduar i funksionit të gjyqtarit në aspektin e efikasitetit dhe mënjanimin e ndalimit në qarkullimin e lëndëve, në qoftë se gjatë vitit nuk plotësohen vendet e gjyqtarëve, si dhe vendet e zbrazura të nëpunësve gjyqësor.

Ndërmerren përpjekje dhe aktivitete në vazhdimësi për zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj në Gjykatën Supreme, në kuptim të realizimit të denjë të kompetencave të Këshillit gjyqësor të RMV dhe veprimit në pajtim me kompetencat ligjore që kanë të bëjnë me zgjedhjen e gjyqtarëve.

## **1.10. Transparenca dhe marrëdhënia me publikun**

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut përpiket sidomos për të njoftuar në kohë publikun për procedurat gjyqësore për të cilat është evident interesimi publik dhe prania e medimeve. Vetëm me çiltërsi, transparencë dhe dhënie të informacioneve të sakta dhe relevante në kohë për Gjykatën në procedura të veçanta mund të mbrohet dhe të rruhet reputacioni i Gjykatës dhe të rritet besimi i publikut ndaj Gjykatës. Në anën tjetër, informimi në kohë dhe me rregull i publikut do të pengojë publikimin e informacioneve të pasakta nga ana e medimeve, që mund të ndikojë në dëm si për Gjykatën ashtu edhe për palët dhe interesin e tyre.

Për sigurimin e kësaj detyre të programit në Gjykatë do të publikohen rregullisht informacione dhe njoftime në ueb faqen e Gjykatës, ndërsa përmes Zyrës për marrëdhënie me publikun do të mundësohet qasja e personave të interesuar për informacionet aktuale dhe procedurat të cilat zhvillohen në Gjykatë në pajtim me dispozitat e Ligjit për udhëheqjen me qarkullimin e lëndëve në gjykatat.

Në ueb faqen e Gjykatës rregullisht do të publikohet rendi i ditës nga puna e Seancës së përgjithshme, qëndrimet parimore të miratuara dhe mendimet juridike të miratuara, konkluzionet dhe të gjitha informacionet tjera lidhur me punën e Seancës së përgjithshme, si dhe rendi i ditës, mendimet juridike dhe konkluzionet nga Seanca e Sektorëve.

Zyra për marrëdhënie me publikun do të ndërmerr aktivitete për përparimin e transparencës në pajtim me aktivitetet e Këshillit për Gjyqësor të Hapur dhe për angazhimet e miratuara në Deklaratën për Gjyqësor të Hapur.

Zyra për marrëdhënie me publikun rregullisht do të komunikojë me përfaqësuesit e mediemeve dhe organizatave civile që e ndjekin punën e gjyqësorit, si dhe me publikun civil më të gjerë.

Në Gjykatë do të caktohet person zyrtar për ndërmjetësimin me informacionet me karakter publik, që do të veprojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit për qasje të lirë në informacionet me karakter publik.

Vendimet e miratuara do të rregullohen si anonime në pajtim me Ligjin për udhëheqjen me qarkullimin e lëndëve në gjykatat dhe të njëjtat do të publikohen në ueb faqen e Gjykatës, me çka mundësohet qasja e publikut në punën e Gjykatës.

## **1.11. Puna financiare**

Në kuadër të buxhetit të miratuar nga ana e Këshillit të buxhetit gjyqësor për vitin aktual, do të sigurohet realizimi i procedurave në kohë për furnizimet publike në pajtim me dispozitat e Ligjit për furnizime publike, dhe përmes menaxhimit me mjetet financiare do të tentohet të paguhet detyrimet në vitin aktual.

Në vitin 2023 do të vazhdojnë aktivitetet dhe procedurat për përmirësimin e kushteve të punës në Gjykatën si një nga faktorët kryesor për realizimin e funksionimit papengesë të Gjykatës.

## **2) Qëllimet e programit**

Për realizimin e suksesshëm të këtij programi është i domosdoshëm pro aktiviteti dhe angazhimi i gjyqtarëve dhe të gjithë të punësuarve në Gjykatën, me qëllim që të arrihen qëllimet e konstatuara të programit dhe detyrat e parashtruara.

Qëllimi themelor i programit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është veprimi efikas, me përditësim dhe transparent dhe vendimmarrja në pajtim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore.



Për realizimin e këtij qëllimi, Gjykata do të vazhdojë me realizimin e kompetencave të saj në pajtim me proceset reformuese dhe me sugjerimet dhe rekomandimet në Raportin e Bashkimit Evropian.

Në këtë drejtim, Gjykata do të vazhdojë me përparimin e praktikës gjyqësore; qëndrueshmërinë e vendimeve; miratimin e qëndrimeve parimore, mendimeve juridike dhe konkluzioneve; ndërmarrjen e aktiviteteve për përfshirjen më të madhe, përparimin e transparencës; përforcimin e statusit të gjyqtarëve dhe integritetit të tyre; statusin e shërbimit gjyqësor dhe veprimin e vazhdueshëm në pajtim me dokumentet strategjike për reformat në sektorin gjyqësor dhe për luftën kundër korrupsionit.

Njëra nga qëllimet themelore të programit është edhe përforcimi i pozitës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me drejtimit strategjike dhe në bazë të principit të pavarësisë së gjyqësorit.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të vazhdojë me aktivitetet për bashkëpunimin më të thelluar me të gjithë faktorët nga sektori gjyqësor, dhe me qëllim për përparimin e përgjithshëm të gjendjes në gjyqësorin dhe përforcimin e rolit dhe pozitës së Gjykatës Supreme në pajtim me përcaktimet kushtetuese.

Në këtë kuptim, Gjykata Supreme do të vazhdojë me intensitet dhe në vazhdimësi të ndërmerr aktivitete për kompletimin e numrit të plotë të gjyqtarëve, rritjen e numrit të nëpunësve gjyqësor, përparimin e sistemit kompjuterik dhe efikasitetin e Trupit punues për standardizimin, përpjekjet e vazhdueshme për punën transparente në pajtim me parimet për gjyqësor të hapur, pjesëmarrjen në përgatitjen e aktvendimeve ligjore dhe dokumenteve strategjike që kanë të bëjnë me gjyqësorin dhe vazhdimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal.

Programi i punës së Gjykatës për vitin 2023 do të fillojë të zbatohet nga dita e miratimit të tij.

Programi i punës së Gjykatës gjatë vitit mund të ndryshohet dhe të plotësohet sipas ndryshimeve dhe rrethanave që shkaktohen.

**KRYETARJA E GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË  
MAQEDONISË SË VERIUT**

**Besa Ademi**